


SHQIPËRIA NË SEPA

PAGESA MË TË LIRA, MË TË SHPEJTA, MË TË SIGURTA

ÇFARË ËSHTË SEPA?

Zona Unike e Pagesave në Euro (SEPA) përfshin 41 shtete, mes tyre edhe Shqipërinë.

Që prej **7 tetorit 2025**, pagesat elektronike në Euro midis Shqipërisë dhe çdo vendi SEPA kryhen me **të njëjtat kushte, shpejtësi dhe tarifa si brenda vendit.**



PËRFITIMET KRYESORE



Deri 10 herë më pak kosto për transfertat në Euro



Përpunim më i shpejtë dhe automatik i transaksioneve



Siguri dhe transparencë sipas standardeve të BE-së



Përfshirje në tregun unik me 40+ vende



Kursim vjetor i vlerësuar 20 milionë €

KUSH PËRFITON?

QYTETARËT

Remitanca më të lira

STUDENTËT

Pagesa universitare më të lehta

Transfertat me partnerët në BE më të shpejta

Integrim dhe konkurrueshmëri më e lartë

SA KUSHTON?

- Pagesat elektronike deri në 20,000 €: **maksimumi 2 €.**
- Nga 20,000 € deri në 100,000 €: **2-10 € (deri 0.01% të vlerës).**
- Mbi 100,000 €: **maksimumi 25 €.**
- Pagesat hyrëse (remitanca): **maksimumi 3 €.**



KUJDES!

Komisionet e aplikuara nga bankat evropiane nuk mund të kontrollohen dhe rregullohen nga Banka e Shqipërisë.

SI FUNKSIONON?

Për të kryer një transfertë në SEPA nevojiten disa elemente të thjeshta:

- Një **llogari bankare** pjesë e rrjetit SEPA
- IBAN-i** i përfituesit (numri ndërkombëtar i llogarisë)
- BIC-i** i bankës përfituese (kodi identifikues ndërkombëtar)
- Pagesa në Euro (€)**

Të dy bankat – ajo e dërguesit dhe e përfituesit – duhet të jenë pjesë e SEPA-s. Shuma e transferuar kreditohet e plotë në llogarinë e përfituesit. Nëse përdorni banking digital (telefon ose kompjuter), pagesa është më e lirë dhe më e shpejtë. Nëse llogaria nuk është në Euro, banka konverton shumën sipas kursit të këmbimit.

